

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6990
E enjte, 7 shtator 2023
Çmimi 0.40

Hasani: Udhëzimi për largim të kryetarëve, kundërkushtetues dhe kundërligjor FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

DËSHMITARI I 22-TË I ZPS-SË DËSHMON NË HAGË NË PROCESIN GJYQËSOR NDAJ HASHIM THAÇIT, KADRI VESELIT, REXHEP SELIMIT DHE JAKUP KRASNIQIT FAQE 4-5

AVOKATËT DEMOLUAN ABRAHAMSI

Avokatët e liderëve të UÇK-së: Dëshmia e Abrahamsit, e bazuar në opinione



Mbrojtja e liderëve të UÇK-së në Hagë është ballafaquar të martën dhe të mërkurën me dëshmitarin e ZPS-së, Frederic Abrahams nga "Human Rights Watch". Abrahams dëshminë e

tij e ka nisur duke përmendur disa intervista dhe deklarata si dëshmi të marra gjatë luftës. Këto dëshmi nga mbrojtja e liderëve të UÇK-së janë vlerësuar opinione. Në këtë

kontekst, mbrojtja ka ballafaquar dëshmitarin ndërkombëtar të prokurorisë me një numër të madh pyetjesh ndaj të cilave nuk ka dhënë përgjigje konkrete

AKTUALE



PËRSËRITJA E PËRBALLJES TRUMP - BIDEN MUND TË JETË E PASHMANGSHME F. 2

OSMANI PARA UDHËTIMIT ZYRTAR PËR NË SELINË E NATO-S TAKON KOMANDANTIN E FSK-së F. 3

FILLON RRUËTIMI I KOSOVËS NË OPEN GOVERNMENT PARTNERSHIP F. 7

EKONOMI



INVESTIMET E HUAJA DIREKTE GJERMANE NË KOSOVË PËR 6 MUAJ ARRITËN 92 MILIONË EURO F. 8

ASK-ja: MBI 80 PËR QIND E FAMILJEVE NË KOSOVË E KANË PËRDORUR DRURIN SI LËNDË DJEGËSE F. 8

SPORT



SHQIPËRIA SYNON FITORE NDAJ ÇEKISË F. 10

DËSHMITARI I 22-TË I PROKURORISË, MAVRAJ: SPEKTAKËL PROFESIONAL I AVOKATËVE MBROJTËS, DEMOLUAN VEGLËN E PROPAGANDËS SERBE



RENOVA
PUTZ
Mqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Përsëritja e përballjes Trump - Biden mund të jetë e pashmangshme

WASHINGTON, 6 SHTATOR - Fundi i fundjavës së Ditës së Punës shënon praktikisht fillimin e një gare të ashpër në Ajova, pasi kandidatët shtyhen për t'u nominuar për president të Shteteve të Bashkuara nga partia e tyre përkatëse. Por, meqë vëmendja po rritet për fushatën zgjedhore të zgjedhjeve presidenciale 2024, furia e zakonshme duket e pashmangshme.

Në mesin e republikanëve, Donald Trumpi po mbizotëron në garën primare, duke i lënë mbrapa rivalët me rezume si guvernatorë, diplomatë dhe sipërmarrës, të cilët në kushte normale do të ishin konkurrentë të fortë. Fuqia e ish-presidentit vjen mbase – apo ndoshta për shkak – të aktakuzave të shumta penale të cilat kërcënojnë ta lënë nën hije çfarëdo debati serioz për të ardhmen e vendit.

Dhe tani për tani miliona dollarët që rivalët republikanë janë duke i derdhur në garë po bëjnë shumë pak për ta dëmtuar Trumpin, duke nxitur shqetësime në mesin e kritikëve të tij në Partinë Republikane, të cilët druhen se gara ka përfunduar para se të fillojë.

Derisa një prirës i garës në telashe po shkon drejt nominimit nga radhët e republikanëve, presidenti Joe Biden është në rrugë të mirë drejt fitores nga radhët e demokratëve. Bideni, 80 vjeç, po përballlet me opozitë simbolike për të nominuarin e demokratëve, me gjithë shqetësimet për paraqitjet dhe moshën e tij nga shumë zyrtarë brenda partisë së tij.

U pëlqeu apo jo votuesve, rimeçi Trump - Biden mund të jetë i pashmangshëm, i cili do të ofronte një sezon zgjedhor tejet të pasigurt, i cili vetëm i thëllon ndarjet politike të vendit.

Trumpi ka vendosur tashmë të mos marrë pjesë në debatet presidenciale të partisë dhe paraqitjet e tij para gjykatës po marrin nganjëherë më shumë vëmendje se tubimet e tij elektorale. Dhe Bideni e ka nisur tashmë fushatën, teksa përballlet me më shumë pyetje rreth moshës dhe për sfidat ligjore të të birit. “Unë thjesht nuk mund ta paramendoj ndryshimin e gjërave kaq dukshëm. Pra, duket se e kaluara është prolog”, tha guvernatori i Kalifornisë, Gavin Newsom, i cili është demokrat, duke i lartësuar arritjet e Bidenit, derisa e paralajmëroi partinë e vet të mos e nënvlerësojnë fuqinë politike të Trumpit.

Newsom tha se shqetësimet për moshën e Bidenit “janë kritika me vend dhe Shtëpia e Bardhë e di këtë”. “Por nëse mosha është e barabartë me rezultatet, atëherë unë mezi e pres ditëlindjen e tij të


85-të”, shtoi ai.

Te republikanët ka drujtje në mesin e donatorëve dhe liderëve të partisë të cilët shpresonin se votuesit konservatorë do ta shmangnin Trumpin duke e parë sulmin e 6 janarit në Kapitol të cilin e nixti ai dhe sfidat serioze ligjore me të cilat përballlet. “Një rimeç Trump - Biden do të ishte katastrofik për vendin. Jam shumë i brengosur për këtë”, tha Bobbie Kilberg, një donatore e rëndësishme republikane, i cila po e përkrah ish-guvernatorin e Nju-Xhersit, Chris Christie. Ajo tha se është e frikshme qysh shumë votues në partinë e saj vazhdojnë ta përkrahin ish-presidentin. “Unë refuzoj të besoj se Trumpi është i nominuari ynë i pashmangshëm”. Ka kohë që peizazhi zgjedhor 2024 të ndryshojë. Kanë mbetur edhe katër muaj para se të hidhen votat e para në Ajova (për nominimin e kandidatëve për president nga të dyja partitë), ndërsa zgjedhjet e përgjithshme janë më shumë se një vit larg. Historia e kohëve të fundit jep shumë shembuj të kandidatëve të anashkaluar dhe gjoja të mposhtur, të cilët dëshmuar se urtësia popullore ishte gabim. Edhe Trumpi e Bideni janë në mesin e tyre. Trumpi po përballlet me 91 akuzat penale në Uashington, Nju-Jork, Florida dhe Atlanta. Ato përfshijnë gjithçka, nga mbajtja e jashtëligjshme e dokumenteve të klasifikuara, përpjekjet për ta zhbërë disfatën në zgjedhjet 2020 e deri te tentimi për t'ia mbyllur gojën me para një ylli të pornografisë.

Ish-presidenti mund të jetë i dënuar me burgim para se të mbahen zgjedhjet e përgjithshme nëntorin e ardhshëm. Prapëseprapë, liderët e parisë – përfshirë shumica e kundërshtarëve të tij republikanë në zgjedhjet primare – janë zotuar se do ta përkrahin atë edhe nëse shpallet fajtor. Dhe asgjë në Kushtetutën e Shteteve të Bashkuara nuk ua ndalon të dënuarve marrjen e detyrës së presidentit.

Senatori i Luizianës, Bill Cassidy, një republikan dhe mjek, ngrii shqetësime për gjendjen fizike dhe shëndetin mendor të Bidenit. “Ai (shëndeti i tij) është thjesht duke u përkeqësuar”, tha ai.

Sipas një sondazhi të “Associated Press”, Bideni është “i vjetër” dhe “i hutuar”, ndërsa Trumpi është “i korruptuar” dhe “i pandershëm”. Këto ishin në mesin e termeve kryesore që amerikanët i përdorën kur u pyetën për ta përshkruar kandidatin kryesues për president të secilës parti. Sipas një sondazhi të ri të Associated Press, ka vetëm një gjë për të cilën republikanët dhe demokratët pajtohen kur bëhet fjalë për presidentin Joe Biden: Shumica në të dy partitë mendojnë se ai



është shumë i vjetër për të qenë president.

Por, liderët në të dy partitë janë të gatshëm t'i anashkalojnë problemet e tilla. Presidenti i Demokratëve të Rinj të Amerikës, Quentin Wathum-Ocama, e pranon se votuesit e rinj nuk janë patjetër entuziastë për një rimeç Trump - Biden, por ai shpreson se kandidatura polarizuese e Trumpit do t'i japë partisë së tij energjinë që Bideni nuk mundet. “Po, njerëzit duan një gjeneratë më të re të politikanëve. Ne gjithmonë kemi folur për Joe Bidenin si - madje edhe ai vetë e ka thënë - si një figurë tranzicionale në jetën tonë politike”.

Zyrtarët demokratë në Kongres dhe në shtetet kryesore janë duke e mbështetur publikisht rizgjedhjen e Bidenit. Senatori i Vermontit, Bernie Sanders, sfiduesi më i fortë i Bidenit në zgjedhjet primare të demokratëve më 2020, e përkrahu rizgjedhjen e Bidenit pak orë pasi u bë publike kandidatura e tij në pranverë. Bideni i futi në listën e bordit kombëtar të këshilltarëve ata që do të ishin rivalët e tij. Përfshirë republikanin Ro Khanna, senatorin D-Calif, guvernatorin e Illinois J. B. Pritzker dhe Newsom. Republikanët kanë sugjeruar se Newsom planifikon ta sfidojë Bidenin në zgjedhjet primare, diçka të cilën guvernatori i Kalifornisë e ka hedhur poshtë vazhdimisht. Kjo madje edhe në një kohë kur Newsom e ka menduar mundësinë për një debat të profilit të lartë kundër guvernatorit të Floridës, Ron DeSantis, i cili është në mesin e sfiduesve kryesorë republikanë të Trumpit.

Newsom tha se do të ketë debat me guvernatorin e Floridës, mbase në nëntor, edhe pse dy kampet janë duke punuar ende rreth hollësive. “Do ta bëj gjënë që mezi pres ta bëj më shumë se çdo

gjë tjetër, dhe kjo (argumenton) për Bidenin dhe atë që e ka arritur ai – dhe ta bëj këtë një kundër një”, tha ai për një debat me DeSantisin. “Kjo është një mundësi, një platformë, të cilën nuk dua ta lëshoj”.

Ndërkohë, në shenjë vetëbesimi, fushata e Trumpit ka filluar tashmë të përgatitet për një betejë kundër Bidenit në zgjedhjet e përgjithshme. Ekipi i tij thotë se ai planifikon të mos marrë pjesë në asnjë debat presidencial republikan. DeSantis, që dikur mendohej se ishte kërcënim i mundshëm, ka hasur në vështirësi për t'i përmbyshur pritjet. “Presidenti përfiton nga të qenët lider i parisë në tetë vjetët e fundit”, tha Brian Jack, drejtor politik i Trumpit.

Trumpi po i prin garës për përkrahje publike, duke e fituar mbështetjen publike të më shumë anëtarëve të Kongresit dhe zyrtarëve të zgjedhur në mbarë shtetin, se të gjithë të tjerët së bashku.

Kandidatët e tjerë po kanë vështirësi ta mbajnë ritmin me fushatën e qetë të Trumpit për kontrollimin e rregullave për përzgjedhjen e delegatëve për zgjedhjet primare shtetërore për individët. Për shembull, zyrtarët e Trumpit me sukses i shtynë republikanët e Kalifornisë t'ia japin të gjithë 169 delegatët shtetërorë fituesit të zgjedhjeve primare të 5 marsit në vend se t'ia ndanin delegatët kandidatëve të shumtë bazuar në proporcionin e votës së tyre.

Duke e parë përparësinë jashtëzakonisht të madhe të Trumpit, disa aleatë të fuqishëm të Trumpit kanë nisur t'u bëjnë thirrje kandidatëve të tjerë republikanë për president të heqin dorë.

Kryetari i Majamit, Francis Suarez, i dha fund përpjekjes jetëshkurtër për Shtëpinë e Bardhë në fund të javës së kaluar, pasi dështoi të

kualifikohej për debatin hapës. Por, të paktën edhe tetë kundërshtarë të profilit të lartë mbesin ende në garë. “Ka muaj që është e qartë se presidenti Trump do të jetë i nominuari i republikanëve”, tha republikania Elise Stefanik. “Këto zgjedhje janë më të rëndësishmet në jetën tonë dhe unë do të vazhdoj t'u bëj thirrje republikanëve që ta përkrahim fushatën e presidentit Trump me tërë mekanizmat e partisë sonë.” Derisa Trumpi mbetet favorit i pastër, ai mban një epërsi më të madhe në tërë vendin se në disa shtete ku votohet më herët.

Republikanët me ndikim atje nuk janë të gatshëm ta pranojnë nominimin e Trumpit akoma. Guvernatori i Nju-Hempshirit, Chris Sununu, vendit i cili e mban garën e dytë primare të republikanëve pas Ajovës, është duke punuar për t'i forcuar rivalët republikanë të Trumpit, duke paralajmëruar se Trumpi ka shumë të meta për t'i fituar zgjedhjet e përgjithshme.

Edhe ish-guvernatori i Ajovës, Terry Branstad, i cili shërbeu si ambasador i Trumpit në Kinë, ka shprehur dyshime për mundësitë e ish-presidentit për t'i fituar zgjedhjet presidenciale, duke marrë parasysh sfidat ligjore të cilat do të zhvillohen gjatë shumicës së vitit të ardhshëm. “Përqendrimi i zgjedhjeve duhet të jetë në Bidenin dhe rekordin e tij. Kjo gjë më shqetëson mua. Kjo u jep përparësi demokratëve”, tha Branstad. Madje as vetë Trumpi nuk është i gatshëm të thotë se e ka siguruar tashmë nominimin republikan për president të Shteteve të Bashkuara.

“Nuk dua të them se gjithçka ka përfunduar, sepse unë s'e them këtë. Unë nuk besoj derisa të përfundojë, apo jo? Siç do të thoshte Yogi 'asgjë nuk ka përfunduar derisa të përfundojë', tha Trumpi /Associated Press

Dëshmitari i 22-të i Prokurorisë, Mavraj: Spektakël profesional i avokatëve mbrojtës, demoluan veglën e propagandës serbe

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Publicisti dhe botuesi i gazetës "Epoka e re" Muhamet Mavraj, ka komentuar seancën e së mërkurës të Gjykatës Speciale - paraqitjen e dëshmitarit të 22-të Zyrës së Prokurorit të Specializuar në rastin e krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Frederic Abrahams, i cili kishte punuar në organizatën "Human Rights Watch".

Mavraj ka shkruar në "Facebook" se gjatë kësaj seance pamë një spektakël profesional të avokatëve mbrojtës, ku demoluan këtë vegël të propagandës serbe. "Kjo racë duke i shlyer kufijtë ndërmjet faktit dhe opinionit, kanë bërë kërdi kundër kombit shqiptar për shumë dekada, prandaj po



rrëshqet prapa në errësirë Kosova pas atyre triumfeve gjigande", ka shkruar Mavraj.

Postimi i plotë i Mavrajt:

Seancat e hapura në Hagë janë rast për të krijuar një perceptim me të qartë për çfarë po ndodh.

Dëshmitari 21 ishte zbatimje e madhe, jo për mezin e humbur para apo gjatë luftës, sepse e kishte gjetur, madje dy, por për nivelin e giorë të prokurorisë atje. Për gjynah!

Ekstremi tjetër është dëshmitari 22, F. Abrahamsi. Spektakël profesional i avokatëve mbrojtës, apotheoze e avokatisë së zgjuar. E demoluan këtë vegël të propagandës serbe që ka shumë shokë e shoqe në Prishtinë. Kjo racë duke i shlyer kufijtë ndërmjet faktit dhe opinionit, kanë bërë kërdi kundër kombit shqiptar për shumë dekada, prandaj po rrëshqet prapa në errësirë Kosova pas atyre triumfeve gjigande. Ju lutem, mos e lëshoni vazhdimin gjatë të enjtes. Kënaqësi ju pret!



Policia e Kosovës shënon 24-vjetorin e themelimit, merr vlerësime pozitive

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Më 6 shtator 1999, pak muaj pas përfundimit të luftës në Kosovë, filloi gjenerata e parë e kadetëve të Policisë së Kosovës. 24 vjet më vonë, me 58 gjenerata deri më tash, policia jonë, mes sfidash të ndryshme e me profesionalizëm e përkushtim, ka shënuar suksese të shumta.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka uruar Policinë e Kosovës për ditën e themelimit. "6 shtatori shënon një moment historik, të rëndësishëm në historinë e Kosovës - ditën e themelimit të Policisë së Kosovës", ka thënë Osmani.

Presidentja Osmani ka thënë se "sot Policia e Kosovës është shndërruar në një simbol të përkushtimit, guximit dhe profesionalizmit të palëkundur për t'i shërbyer të gjithë qytetarëve, pa dallim. Ata janë gardianë të sigurisë sonë, të mbrojtjes së sovranitetit të Republikës". Sipas presidentes Osmani, gra e burra të Policisë së

Kosovës janë kurdoherë të gatshëm për t'iu përgjigjur çdo situatë. "Gra e burra të Policisë së Kosovës janë kurdoherë të gatshëm për t'iu përgjigjur çdo situatë, për ta ofruar ndihmën e tyre dhe për ta mbrojtur rendin dhe ligjin, ndaj një falënderim i përzemërt për secilin prej tyre! Zotimi, përkushtimi dhe profesionalizmi juaj, janë shprehë dhe garanci për qytetarët e Kosovës për një mjedis të qetë dhe të sigurt! Urime dita e themelimit të Policisë së Kosovës!", ka theksuar presidentja Osmani.



Kryeministri Albin Kurti ka thënë se që nga gjenerata e parë policore kur filloi trajnimin më 6 shtator 1999, policia jonë shërbeu për të gjithë qytetarët tanë duke mbrojtur jetën dhe pronën e tyre e duke ruajtur sovranitetin e vendit tonë. "Si Qeveri e Republikës së Kosovës jemi zotuar për luftim të krimit, korrupsionit dhe çdo ilegaliteti që cenon sigurinë e vendit tonë e të qytetarëve tanë dhe jam mirënjohës që në këtë rrugëtim prej më shumë se dy vujetësh kemi arritur suksese falë zrytarëve policorë të përkushtuar

e profesionalë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Mbi 1 100 operacione të realizuara, 100 grupe kriminale të shkatërruara, mbi 2 200 kg substanca narkotike të konfiskuara, 16 laboratorë të drogës të shkatërruar, janë suksese që Policinë e Kosovës e kanë renditur ndër institucionet më të besueshme për qytetarët tanë, ndërsa republikën tonë e kanë ngritur në listat e shteteve serioze e të përkushtuara për luftimin e kriminalitetit", ka shkruar Kurti në "Facebook". Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka thënë se Policia e Kosovës është treguar e suksesshme në veri të vendit, siç ka thënë, pas një kohe të gjatë. Ai ka premtuar më shumë luftë kundër shkelësve të ligjit. Në 24-vjetorin e themelimit të Policisë së Kosovës, Sveçla ka folur për profesionalizmin e tyre. "Është mirë që Policia e Kosovës pas një kohe të gjatë është jashtëzakonisht e suksesshme në atë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës. Kjo tashmë është e evidente. Unë jam i bindur që puna e policisë nuk

do të ndalet me kaq. Është falë edhe profesionalizmit të njësiteve të cilat ne i vizitua. Numri i rasteve të pazbuluara është minimal përfshirë edhe atë pjesë të republikës sonë", ka thënë ai. Sveçla ka thënë se anëtarësimi i PK në Interpol është duke u bërë për shkak të pengesave politike. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, ka thënë se qytetarët në vend nuk kanë nevojë të ndihen të frikësuar, përveç atyre që janë në kundërshtim me ligjin. Ai ka folur edhe për pajisjet e ekspozuara të policisë në sheshin "Skënderbeu". "Qëllimi i kësaj ekspozite është që qytetarët tanë të ndihen të sigurt që këto pajisje janë për të garantuar rend dhe ligj, për t'i ndihmuar ata që të jetojnë qetë dhe sigurt në vendin tonë. Nuk ka nevojë të frikësohet nga PK-ja askush, përveç atyre që janë në kundërshtim me ligjin. Këto pajisje do të përdoren për ata që bëjnë keq dhe që janë në kundërshtim me ligjin të dalin para drejtësisë dhe ta marrin dënimin e merituar", ka thënë ai.

Osmani para udhëtimit zyrtar për në selinë e NATO-s takon komandantin e FSK-së

Prishtinë, 6 shtator - Para udhëtimit zyrtar për në selinë e NATO-s, presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur në takim punë komandantin e FSK-së, gjenerallejtnant Bashkim Jasharin. Me këtë rast, presidentja Osmani në cilësi të Komandantes Supreme të FSK-së u njoftua nga gjenerallejtnant Jashari për aktivitetet dhe zhvillimet aktuale në FSK, me theks të

veçantë për procesin e realizimit të Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit gjatë vitit 2023 dhe rritjen e mirëqenies së ushtarëve dhe ushtarakëve të FSK-së. Po ashtu, presidentja Osmani ka diskutuar me gjenerallejtnant Jasharin për bashkëpunimin e ngushtë me partnerin kryesor strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si dhe me shtetet e tjera të NATO-s, lidhur me

çështje të sigurisë në vend dhe rajon.

Të dy ritheksuan se vizioni ynë i përbashkët është që Republika e Kosovës ta zhvillojë ushtrinë e saj në përputhje me standardet e vendeve anëtare të NATO-s, për të qenë forcë e ndërveprueshme në misionet e përbashkëta me forcat aleate në shërbim të paqes, stabilitetit dhe sigurisë rajonale dhe globale.





DËSHMITARI I 22-TË I ZPS-SË DËSHMON NË HAGË NË PROCESIN GJYQËSOR NDAJ HASHIM THAÇIT, KADRI VESELIT, REXHEP SELIMIT DHE JAKUP KRASNIQIT

AVOKATËT DEMOLUAN ABRAHAMSI

Avokatët e liderëve të UÇK-së: Dëshmia e Abrahamsit, e bazuar në opinione

Mbrojtja e liderëve të UÇK-së në Hagë është ballafaquar të martën dhe të mërkurën me dëshmitarin e ZPS-së, Frederic Abrahams nga "Human Rights Watch". Abrahams dëshminë e tij e ka nisur duke përmendur disa intervista dhe deklarata si dëshmi të marra gjatë luftës. Këto dëshmi nga mbrojtja e liderëve të UÇK-së janë vlerësuar opinione. Në këtë kontekst, mbrojtja ka ballafaquar dëshmitarin ndërkombëtar të prokurorisë me një numër të madh pyetjesh ndaj të cilave nuk ka dhënë përgjigje konkrete

EPOKA E RE

Lirim GECI

HAGË, 6 SHTATOR - Dëshmitari i njësuar dhe i detyrës së Prokurorisë të Specializuar (ZPS) në Gjykatën Speciale në Hagë në rastin e drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është Frederic Abrahams. Ai është punëtor në organizatën "Human Rights Watch". Abrahams dëshminë e tij në Speciale si dëshmitari i ZPS-së e ka nisur të martën. Ai në ditën e parë të dëshmisë ka bërë me dije se kishte mbledhur intervista dhe deklarata nga qytetarë lidhur me disa krime të pretenduara nga ushtarët e UÇK-së. "Në rastin e hetimit, shkeljeve të pretenduara të bëra nga UÇK-ja, intervistat ishin të vështira sepse kishte hezitim dhe frikë për të folur hapazi për këtë çështje", ka thënë Abrahams. Dëshmitari Abrahams ka theksuar se raportet për luftën i kanë bërë

më shumë kolegët e tij, por se edhe ata kishin thënë se janë përballur me njerëz që kanë shprehur frikë për të dhënë përgjigje që përfshijnë shkeljet e pretenduara të UÇK-së. "Unë e kuptoja dhe besoja frikën e njerëzve nga pasojat që mund të kishin", ka thënë Abrahams kur është pyetur nga prokurori Alan Tieger se për çfarë kishin frikë këta persona. Dëshmitari ka thënë se nuk kanë qenë të vendosur përherë në Kosovë, por kanë ardhur dhe qëndruar nga dy-tri javë herë pas here. Metodika e punës, sipas tij, ishte intervistimi i personave që pasqyrojnë njohuri të dorës së parë, ata që kanë parë me sy të vet shkeljen apo familjarë të tyre, por se janë munduar që dëshmitë e tyre t'i mbështetin me materiale përcjellëse si: raporte autopsie, raporte mjekësore apo vendime gjykatë. Abrahamsi ka thënë se raportet e

tyre pas botimit i kanë shpërndarë online, "u është dërguar qeverive të ndryshme dhe organizatave ndërkombëtare, janë vënë në kontakt me medie si dhe kanë bërë shpërndarje të drejtpërdrejtë tek autoritetet serbe-jugosllave". Për shpërndarjen e raporteve nga

UÇK-ja ai ka thënë se nuk kishte qenë e lehtë pasi fillimisht nuk ka qenë prania e tyre hapazi deri vonë gjatë konfliktit, kurse më vonë, nga shtatori i 1998-s, i kanë bërë shpërndarë ato në zyrën e përfaqësuesve në Prishtinë, sipas tij, te Adem Demaçi, aktivisti i të drejtave të njeriut dhe përfaqësues politik i UÇK-së. Në vazhdim dëshmitari është pyetur edhe për ndalimin e dy gazetarëve serbë nga UÇK-ja, për të cilët ka thënë se kishin paraqitur shqetësimin e tyre me komunikatë për shtyp, por se ishin konsultuar edhe me Kryqin e Kuq Ndërkombëtar dhe e kishin ngritur si çështje edhe me Demaçin në Prishtinë.

Avokatët e liderëve të UÇK-së: Dëshmia e Abrahamsit, e bazuar në opinione

Megjithatë, avokatët e liderëve të UÇK-së kanë pasur kritika lidhur me dëshminë e Abrahamsit. Avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, ka thënë se dëshmia e tij është e bazuar në opinione. "Ne e dimë që ky dëshmitar nuk u ka të bazuara shumicën e gjërave që i thotë. Këtë e ka thënë në shënim përgatitor, edhe në deklarata të ndryshme. Ai thotë 'nuk e di kush e ka thënë këtë', madje thotë se 'nuk kemi pasur mundësi t'i hetonim krimet që pretendoheshin se kryheshin nga UÇK-ja'. Ai nuk ka pasur drejtpërdrejt asnjë përfshirje", ka thënë Emmersoni të martën. Ai ka shtuar se duhet të shihet me hollësi se cilat raporte mund të citohen nga ky dëshmitar, ndërsa ka kërkuar nga trupi gjyqësor të marrë një vendim lidhur me këtë. Pasi i ka dëgjuar parashtrimet, kryetari i trupit gjyqësor, Charles Smith, ka thënë se prokuroria duhet ta vërtetojë bazën e opinionit të dëshmitarit. "Trupi gjyqësor i kujton ZPS-së që nëse ka ndërmend të mbështetet në opinione të tilla në këtë dëshmitar duhet ta vërtetojë bazën, ta gjejë



Kurti i akuzon “aleatët e Ruisisë” për minimin e dialogut Kosovë - Serbi

PRISHTINE, 6 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, akuzoi “aleatët e Ruisisë” se përmes dezinformimit dhe sjelljeve të tjera dashakeqe në fushën kibernetike, po ndikojnë në procesin e normalizimit të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Kurti gjatë samitit “Open Government Partnership” në Tallin të Estonisë tha se këto veprime në Kosovë janë duke u shuar. “Në Kosovë përpjekjet nga aleatët e Ruisisë për ta shtrembëruar të vërtetën, të kaluarën dhe të tashmen, janë të dukshme dhe po intensifikohen. Gjatë kohës së ndjeshme, kur shteti ynë është i përkushtuar në procesin e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara për të normalizuar raportet me



fqinjën tonë veriore, Serbinë, por edhe për përfshirjen e plotë të minoriteteve në proceset demokratike të shtetit, pa ndikim nga jashtë, këto kërcënime

kibernetike, sikurse dezinformimi, bullizimi kibernetik dhe forma të tjera, janë veçmas përcaktuese”, tha Kurti.

Edhe në të kaluarën autoritetet në

Kosovë e kanë akuzuar Ruisinë se po e shtyn aleaten e saj, Serbinë, të nxisë tensione në Kosovë, përkatësisht në veriun e banuar me shumicë serbe. Por, këto pretendime janë hedhur poshtë nga Kremli. Po ashtu, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian vazhdimisht kanë paralajmëruar për ndikimin rus në Ballkanin Perëndimor. Në një raport të mëhershëm të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë thuhej se ndikimi i Ruisisë në Kosovë mund të interpretohet si “keqdashës” dhe “armiçësor”. Por, në raport u tha se operacionet ruse të ndikimit “janë kryesisht të kufizuara te serbët e Kosovës”. Komentet e bëra nga Kurti më 6 shtator vijnë disa ditë pasi presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, pa ofruar prova, tha se

Serbia synon të zbatojë një plan të ngjashëm me atë që zbatoi Rusia në Ukrainë më 2014. Ajo iu referua aneksimit të paligjshëm të Krimesë dhe mbështetjes së separatistëve pro-rusë në luftën e tyre kundër forcave ukrainase në rajonin lindor të Donbasit. Që nga viti 2011 Kosova dhe Serbia zhvillojnë dialog për normalizimin e plotë të raporteve nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. Raundi i ri i dialogut pritet të zhvillohet më 14 shtator, pas rritjes së tensioneve mes dy vendeve. Tensionet u rritën në fund të shkurtit në veri të Kosovës, pasi banorët serbë që jetojnë në atë zonë, po kundërshtojnë kryetarët e rinj shqiptarë. Autoritetet qendrore së fundi kanë ndërmarrë hapa që do të mundësonin shkarkimin e kryetarëve përmes një peticioni.

bazën ku e ka formuar ky dëshmitar opinionin. Palët dhe pjesëmarrësit do të jenë në gjendje ta kundërshtojnë një pjesë të caktuar të pyetjeve për diçka që ata mendojnë se nuk është provuese në rastin tonë konkret”, ka thënë Smith.

Mbrojtja e drejtuesve të UÇK-së “demolon” dëshmitarin Abrahams

Dëshmitari i Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) në Hagë nga “Human Rights Watch”, Frederic Abrahams, ka vazhduar edhe të mërkurën dëshminë e tij në procesin gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së. Ai është përgjigjur në pyetjet e prokurorisë dhe të avokatëve të liderëve të UÇK-së. Abrahams ka folur lidhur me pretendimet e kësaj organizate për abuzimet që kanë ndodhur gjatë luftës në Kosovë. Ai ka thënë se këto pretendime për të cilat ka folur edhe të martën janë të bazuara nga informacionet që kanë marrë nga terreni. Lidhur me këto pretendime, fillimisht ka reaguar avokati i Veselit, Ben Emmerson. Ai ka thënë se provat e dëshmitarit Abrahams janë të papranueshme dhe jashtë kompetencave së Gjykatës Speciale. “Dëshmitari nuk përmend burimin e informacionit mbi të cilën është bazuar kjo pjesë. Kjo është përpiluar, siç e tha vetë dëshmitari, për të prezantuar dhe ndërtuar një rast. Pra është konceptuar që të paraqesë një argument që rastësisht përputhet edhe me atë të prokurorisë. Kjo nuk është provë e pranueshme. Mbi këtë bazë gjykata nuk mund të vlerësojë lidhur me besueshmërinë e kësaj prove. Fakti që dëshmitari thotë: ‘ne besonim, menduam që ishte’, kjo është punë e gjykatës. Këtë e bën gjykata, nuk e bën ‘Human Rights Watch’ për t’i lexuar raportet e përpiluara nga palët e treta dhe pa intervistuar burimet”, ka thënë Emmersoni.

Kërkesa e Emmersonit, që prova e dëshmitarit të mos pranohet, është refuzuar nga kryetari i trupit



gjyqës, i cili ka thënë se dëshmitari Abrahams vetëm ka treguar se si janë mbledhur dëshmitë. Pas kësaj, fjalën e ka marrë avokati i Hashim Thaçit, Gregory Kehoe. Ai e ka pyetur dëshmitarin se a kanë intervistuar ndonjë pjesëtarë të familjeve të cilave pretendohet se u është marrë ndonjë i afërm. “Nuk mund ta them këtë sepse personalisht nuk kam parë diçka të tillë. Për kolegët e mi është sigurisht po”, ka thënë dëshmitari.

Po ashtu, avokati i Thaçit e ka pyetur dëshmitarin Abrahams se kush janë pjesëtarët e familjes që janë marrë në pyetje nga “Human Rights Watch”, por nuk ka qenë në gjendje të japë përgjigje konkrete. “Sot në këtë bankë nuk mund t’ju jap emra”, është përgjigjur dëshmitari Abrahams.

Më tutje, avokati i Thaçit e ka pyetur dëshmitarin Abrahams se a i ka parë shënime të personave të cilët kanë dhënë dëshmi para se ta jepte dëshminë para ZPS-së. As këtu dëshmitari Abrahams nuk ka dhënë përgjigje të qartë. “Nuk më kujtohet nëse i pashë edhe njëherë shënime sepse ka kaluar kohë, por për paraqitjen këtu sot, sigurisht jo”, është përgjigjur dëshmitari Abrahams.

Në këtë kontekst, avokati i Thaçit e ka pyetur dëshmitarin Abrahams se a janë të “Human Rights Watch” shënime të cilave është duke iu referuar. “Këto shënime janë të miat dhe janë në zotërimin tim, por nuk i ndaj me prokurorin dhe me askënd tjetër sepse është material i klasifikuar”, është përgjigjur

dëshmitari Abrahams.

Avokati i Thaçit ka insistuar të marrë përgjigje më konkrete për këto shënime nga dëshmitari Abrahams. Ai e ka pyetur dëshmitarin sa a i ka lexuar shënime para se të përgjigjet në pyetjet e prokurorisë. Dëshmitari Abrahams ka thënë se nuk i ka parë ato shënime para se ta jepte dëshminë. Pas kësaj ka pasuar pyetja tjetër e avokatit të Thaçit, duke e pyetur Abrahamsin se kur i ka parë shënime dhe se a ka kërkuar ZPS-ja t’i marrë këto shënime. Ndaj kësaj pyetjeje dëshmitari është përgjigjur shkurt “Jo”.

Avokati i Thaçit e ka pyetur dëshmitarin edhe për takimet me Adem Demaçin. Ai ka pranuar se e ka takuar dy herë Demaçin gjatë kohës së luftës.

Avokati Gregory Kehoe e ka ballafaquar dëshmitarin me një dokument të Adem Demaçit në të cilin gjendet edhe emri i Albin Kurtit. Në këtë dokument kërkohej lirimi i disa gazetarëve të “Tanjug”-ut. Në këtë kontekst, avokati i Thaçit i është referuar deklaratës se një ditë më parë të dëshmitarit Abrahams.

Procesi gjyqësor ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit ka nisur më 3 prill të këtij viti, ndërsa ata janë duke u mbajtur në paraburgim që nga nëntori i vitit 2020. Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi janë deklaruar të pafajshëm për akuzat me të cilat është duke i ngarkuar Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë.

Avokati i Veselit ‘shkatërron’ provat e dëshmitarit Abrahams, e detyron ta pranojë se gaboi rëndë në konstatimet për UÇK-në

Avokati Emmerson i ka kundërshtuar fuqishëm konstatimet e Abrahams, për “vrasjen e civilëve nga UÇK-ja në shtator të vitit 1998”. Gjatë marrjes në pyetje, Emmersoni e ka detyruar Abrahamsin të pranonte se ka gabuar në raportin e tij kur ka bërë konstatime të tilla, e për më tepër, nga burime serbe që nuk i kishte hetuar dhe konfirmuar. Pjesë nga biseda mes Emmersonit dhe Abrahamsit:

Emmersoni: Ju keni ricikluar propagandën serbe apo jo?

Abrahamsi: Duhej të ishte shkruar ndryshe.

Emmersoni: Këto pretendime i morët nga pala serbe?

Abrahamsi: Po

Emmersoni: A keni intervistuar ndonjë dëshmitarë sa i përket vrasjeve të pretenduara?

Abrahamsi: Po

Emmersoni: Kur thoni vrasja e shtatorit të 1998-s, a e kuptuat se në aktakuzë nuk ka vrasje në shtator?

Abrahamsi: Është formuluar keq...!

Emmersoni: Është e gabuar...? Kur po flisni për vrasjen e shtatorit... s’ka pasur fare vrasje...A ishte tërësisht e gabuar...? Na thatë se jepni mësim për studentët. Ju duhet të bëni dallimin mes provave dhe vlerësimit forenzik. I vetmi

vlerësim i saktë është se janë gjetur trupa të pajetë në Glllogjan në fund të 1998-s...

Abrahamsi: Fjalja duhej të ishte shkruar ndryshe, për pretendime se janë vrarë nga UÇK... Unë mund të të flas për një rast tjetër, për një pretendim....

Emmersoni: Na dëshmuat se sa e rëndësishme ishte dhe cila ishte metodologjia me të cilën bëtë hetimet tuaja, dhe nuk keni respektuar asnjë prej tyre...? Ju nuk keni bërë hetime sa i përket pretendimeve të autoriteteve serbe?

Abrahamsi: S’kemi bërë hetime në tërësi. E kam përmendur këtë, por nuk është reflektuar në mënyrë të saktë. Ne asnjëherë nuk e kemi prezantuar rastin e Glllogjanit në Liqenin e Radoniqit.

Emmersoni: Ju nuk keni shkruar në vendngjarja apo jo?

Abrahamsi: Ne shkuam në vendin e krimit. U përpoqëm që të shkonim në Liqen...Në atë pikë që shkuam ne trupat ishin larguar dhe po mbaheshin në një hotel në një morg të sajuar dhe ne nuk u lejuam që të shkojmë në hotel.

Emersoni: Por ju nuk shkruar tek Liqeni?

Abrahamsi: Jo nuk shkuam atje. Shkuam te morgu i improvizuar.

Emmersoni: Ju s’kemi qenë në gjendje të bëni gjëra...

Rektori i UP-së pret në takim Grupin Punues të Këshillit Konsultativ për Komunitete

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Rektori i Universitetit të Prishtinës, Qerim Qerimi, ka pritur në takim Grupin Punues të Këshillit Konsultativ për Komunitete. Siç njofton UP-ja, është diskutuar për këto tema: regjistrimi i studentëve nga

komunitetet joshumicë për vitin 2023/2024 dhe përfshirja e studentëve joshumicë në Parlamentin Studentor. Rektori Qerimi ka theksuar përkushtimin e universitetit për gjithëpërfshirje dhe mundësi të barabarta

arsimore për të gjithë studentët.

Përfaqësuesit nga universiteti dhe anëtarët e grupit punues u pajtuan të bashkëpunojnë që të ndikojnë pozitivisht te studentët nga komunitetet joshumicë.



Deri në 70 euro një metër dru në Prishtinë

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Disa metra larg shkollës "Nazim Gafurri", dhjetëra kamionë të ngarkuar me dru po qëndrojnë aty. Ekonomia Online ka qëndruar për të pyetur për çmimin e tyre. Ndonëse nuk u prononcua askush nga shitësit, prapa kamerës thanë se çmimi sillet nga 65 deri në 70 euro për metër. Për shkak të çmimeve të larta ka bërë që të bie edhe interesimi i

qytetarëve për furnizim. Çmim i shtrenjtë po i duket edhe qytetarit Hasan Shkodra. Tha se i ka edhe disa metra të blerë nga viti i kaluar. "Ende nuk i kam blerë drutë, por i kam disa që i kem blerë vjet. Me marr dimër i rëndë, ndoshta shtrenjtohen ende. Nuk kemi çfarë të bëjmë, me diçka duhet me u nxe", tha Shkodra për Ekonomia Online.

Nura viziton dy shkolla në Skenderaj

SKENDERAJ, 6 SHTATOR - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura dhe drejtori për Arsim, Kastriot Duraku, kanë vizituar të mërkurën dy shkolla fillore në qytetin e Skenderajt. Ata janë pritur nga drejtorët dhe mësimmthënësit e tyre. Vizita e kryetarit Nura bëhet në javën e parë të vitit të ri shkollor, ndërsa kishte për qëllim të shohë nga afër procesin i cili

nisi me vështirësi shkak i mungesës së librave dhe teksteve të tjera shkollore. Drejtorja e Arsimit i ka bërë të gjitha përgatitjet e duhura për të nisur mbarë viti shkollor. Në këtë kuadër, përveç angazhimeve të tjera, janë rinovuar shtatë objekte shkollore, ku mësimi tashmë zhvillohet në kushte shumë më të mira.



Kamenica dhe USAID-i fillojnë bashkëpunimin për kontratën sociale

KAMENICË, 6 SHTATOR - Kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, me bashkëpunëtorë, ka marrë pjesë në punëtorinë dyditore të organizuar nga USAID-i për direktivat e

përshtatjes dhe zbatimit të kontratës sociale. Ky projekt ka për qëllim avancimin dhe krijimin e praktikave të reja dhe më efikase për pjesëmarrjen e qytetarëve në

vendimmarrje dhe dëgjime publike. Kjo punëtori është vetëm një nga hapat fillestar të bashkëpunimit me USAID-in në kuadër të Kontratës Sociale.

Kryetari i Gjilanit dhe ministri Rashiq flasin për çështjet e komuniteteve joshumicë

GJILAN, 6 SHTATOR - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, bashkë me kolegë e bashkëpunëtorë, ka pritur në takim ministrin për Komunitete dhe Kthim, Nenad Rashiq dhe stafin e tij. "Diskutuam për çështjet e komuniteteve joshumicë dhe

mundësitë e bashkëpunimit për ofrimin e kushteve më cilësore për këtë kategori, si dhe vizituaam çerdhen në fshatin Shillovë, ku u njoftuam nga afër me nevojat dhe sfidat e tyre", ka thënë kryetari i komunës së Gjilanit. Ai ka theksuar se

ministri Rashiq shprehu gatishmërinë e tij për përkrahje financiare të projekteve tona në të mirën e komuniteteve joshumicë e të cilat janë të shumta. "Bashkë qeverisim, për të gjitha shtresat", ka thënë kreu i Gjilanit, Alban Hyseni.



Hasani: Udhëzimi për largim të kryetarëve, kundërkushtetues dhe kundërligjor

Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Enver Hasani, ka thënë se një udhëzim administrativ i lëshuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për largimin e kryetarëve të komunave nga funksioni është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës. “Përmes një udhëzimi të tillë, për gjashtë muaj mund të përmbysen të gjitha rezultatet e zgjedhjeve, gjë që është e ndaluar, është tërësisht jokushtetuese”, ka pohuar Hasani

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Enver Hasani, ka thënë se një udhëzim administrativ i lëshuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për largimin e kryetarëve të komunave nga funksioni është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës.

Në një intervistë për “Radion Evropa e Lirë”, ai e mbështet këtë qëndrim të mungesa e një ligji për iniciativë qytetare apo referendum. “Ai udhëzim shihet që është bërë nga njerëz që e njohin drejtësinë, përkundër që është kundërkushtetues dhe kundërligjor. Ai nuk vlen vetëm për komunat e veriut. Vlen për krejt Kosovën. Përmes një udhëzimi të tillë, për gjashtë muaj mund të përmbysen të gjitha rezultatet e zgjedhjeve, gjë që është e ndaluar, është tërësisht jokushtetuese. Aty përmendet

45-ditëshi. Pse përmendet ai afat, me çfarë të drejte? Duhet pasur autorizim ligjor. Pastaj, ku është logjika e autorizimit të KQZ-së, përmes udhëzimit administrativ të ministrisë? KQZ-ja vetë është organ administrativ. Ata dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal janë të barabartë para ligjit. Ato e zbatojnë ligjin direkt. Ato e marrin udhëzimin prej ligjit, jo prej njëra-tjetres”, ka thënë ai.

Mes të tjerash, Hasani, aktualisht profesor i së Drejtës dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës, ka thënë se pushteti po tregon mungesë vullneti për zgjidhjen e situatës në veri të Kosovës dhe se dorëheqja e kryetarëve të katër komunave të banuara me shumicë serbe në atë pjesë do të ishte vendimi më i duhur. Në pyetjen se a është udhëzimi i ri administrativ për largimin e një



kryetari komune në përputhje me Kushtetutën e Kosovës?, Hasani është përgjigjur: “Jo, sepse caktimi i të drejtave dhe detyrimeve, dhe mënyra e realizimit të tyre, duhet fillimisht të përcaktohet me ligj. Kushtetuta kërkon ligj. Këtu bëhet fjalë për demokracinë e drejtpërdrejtë, që është kategori kushtetuese, dhe mënyrat e realizimit të saj përcaktohen me ligj, zakonisht quhet Ligj për Iniciativën Qytetare, Ligj për Referendum, ose Ligj për Referendum dhe Iniciativë Qytetare. Kushtetuta tregon se çka mund të jetë dhe

çka nuk mund të jetë subjekt i referendumit. Pastaj, ligjvënësi është i lirë t’i përcaktojë këto dy çështje. Por, këto dy çështje nuk i ka rregulluar Kuvendi i Kosovës dhe, për pasojë, ky udhëzim e ka uzurpuar një autorizim ligjor të Kuvendit, dhe e ka normuar një çështje që është dashur të normohet me Ligjin për Iniciativën Qytetare”. Se çfarë mund të ndodhë tash, Hasani tregon ecurinë e procesit. “Jam shumë i sigurt se nëse përfundon në Gjykatë Kushtetuese, ky udhëzim rrëzohet për arsyet që i thashë, por edhe

për arsyen tjetër, që udhëzimin administrativ me përmbajtje të thellë të normave ligjore e ka nxjerrë organi administrativ, që është dikasteri ministror. Ky është konflikt i hapur i interesit, sepse këtu nuk bëhet fjalë për specifikimin e procedurave të realizimit të një të drejte, por caktohen të drejta shtesë prej autorizimit të zëvendëskryesuesit, pastaj mandatimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për organizim të zgjedhjeve, gjë që mund ta bëjë vetëm ligji, jo udhëzimi administrativ”, ka theksuar Hasani.

Fillon rrugëtimi i Kosovës në Open Government Partnership

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, mori pjesë në Samitin Global të 8-të të Partneritet për Qeveri të Hapur (Open Government Partnership) në Tallinn të Estonisë. Në sesionin hapës të samitit që këtë vit po organizohet nga Qeveria e Estonisë, duke iu drejtuar pjesëmarrësve, përfaqësues të shteteve anëtare, aktivistë të shoqërisë civile dhe mysafirë të ftuar, ai tha se ndihet i nderuar që është në mesin e tyre sot, veçanërisht krejt në fillim të rrugëtimin të Kosovës si anëtarja më e re e kësaj organizate ndërkombëtare. “Për Kosovën anëtarësimi dhe pjesëmarrja në OGP paraqet një mundësi për t’i përmirësuar standardet tona të transparencës, pasi që inkurajon qeverinë të jetë më e hapur për aktivitetet e saj dhe proceset vendimmarrëse, po ashtu rrit besimin e publikut”, u shpreh kryeministri.

Ai tha se të qenit pjesë e kësaj organizate e vendos Kosovën në



skenen ndërkombëtare si një vend i përkushtuar ndaj parimeve të hapura të qeverisë, ndaj praktikave të mira të qeverisjes dhe është e gatshme të mbahet përgjegjëse për angazhimet e saj dhe të mësojë

nga ata që kanë përmirësuar praktikën e qeverisjes së hapur. Kurti vazhdoi të thotë se nëpërmjet transformimit digjital synojnë ta rritin cilësinë e sistemit e arsimit, efikasitetin e sistemeve tona të kujdesit

shëndetësor e drejtësisë dhe produktivitetin në ekonomi. “Gjatë dy viteve të fundit kemi digjitalizuar me sukses më shumë se 150 shërbime, të cilat janë të qasshme përmes portalit qeveritar e-Kosova, derisa

aktualisht jemi në proces të pilotimit për ofrimin e shërbimeve në lidhje me lindjen e fëmijëve”, është shprehur ai.

Kryeministri Kurti foli edhe për rrezikun me të cilin ballafaqohet çdo vend nga kërcënimet kibernetike. Ai veçoi rreziqet me të cilat ballafaqohet Kosova nga aleatët e Rusisë, të cilët përpiqen ta shtrembërojnë të vërtetën, të kaluarën dhe të tashmen. “Në situata të ndjeshme, kur vendi ynë angazhohet në procesin e lehtësuar nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës për normalizimin e marrëdhënies me Serbinë, si dhe pjesëmarrjen e plotë të të gjitha pakicave në proceset demokratike të vendit pa ndërhyrje të huaja, kërcënimet kibernetike të llojit të dezinformimit, ngacmimi kibernetik dhe forma të tjera janë veçanërisht të dëmshme”, ka theksuar Kurti. Prandaj, sipas tij, kjo është arsyeja pse angazhimi dhe pjesëmarrja e Kosovës në këtë ngjarje janë më të rëndësishme se kurrë dhe se mezi presin të mësojmë nga të gjithë për një demokraci digjitale më të fortë për qytetarët e Kosovës.

Investimet e huaja direkte gjermane në Kosovë për 6 muaj arritën 92 milionë euro

PRISHINË, 6 SHTATOR - Drejtoresha e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare, Nora Hasani, ishte pjesë e pritjes së një delegacioni gjerman, organizuar nga zyra e fondacionit politik gjerman Konrad Adenauer Stiftung (KAS). Me një përbërje prej udhëheqësish të bizneseve, organizatave, odave dhe zyrave ekonomike gjermane, interesimi i tyre

ishte i fokusuar në aspektin ekonomik. Interesimit të tyre për zhvillimet ekonomike në vend iu përgjigj Hasani, duke dhënë një pasqyrë të qartë të Kosovës ekonomike dhe marrëdhënieve ekonomike gjermano-kosovare. Ajo që u vu në pah ishte se Kosova ka partner kryesor Gjermaninë për të bërit biznes që nga paslufta.

Këtë e thonë statistikat mes dy vendeve, ku Investimet e Huaja Direkte nga janari deri në qershor të këtij viti kapin vlerën 92 milionë euro. Në anën tjetër eksporti i produkteve të Kosovës në Gjermani në shtatëmujorin e parë të këtij viti ka mbërritur 52 milionë euro përballë importit nga Gjermania në Kosovë me 414 milionë euro.



Porti i Durrësit shënon rritje të dukshme të trafikut nga tregtia e jashtme e Kosovës

DURRËS, 6 SHTATOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, gjatë vizitës në Shqipëri, ka vizituar Portin e Durrësit. Ajo ka parë arritjet e jashtëzakonshme që rezultojnë nga aranzhimi për kryerjen e operacioneve të zhdoganimit në Portin e Durrësit që nga 1 tetori i vitit të kaluar. Kjo nismë strategjike, e mbështetur nga marrëveshja ndërshtetërore në mes të dy qeverive dhe e dekretuar nga presidentja Osmani dhe nxitur nga bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, ka sjellë përfitime të konsiderueshme për të dyja vendet. Me rastin e vizitës presidentja Osmani ka shprehur mirënjohjen e saj për doganat e të dyja vendeve, duke theksuar rëndësinë e përdorimit të këtij Porti nga ana e bizneseve të Kosovës dhe duke vënë në pah se zhdoganimi i Doganës së Kosovës në Portin e Durrësit kursen kohën dhe koston, sikurse edhe e lehtëson operimin e bizneseve të Kosovës në tregjet ndërkombëtare.

Nga aty u theksua se një nga arritjet e theksuara është ulja e ndjeshme e kostove për ekonominë e Kosovës, duke arritur në një kursim vjetor prej 9 milionë eurosh. Ky efikasitet i koston ka kontribuar drejtpërdrejt në mirëqenien ekonomike të Kosovës dhe bizneseve të saj. Partneriteti ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë e ka ngritur



integrimin e sistemit në një nivel më të lartë, duke shërbyer si shembull unik në regjionin tonë. Kjo jo vetëm që thjeshton proceset doganore, por gjithashtu siguron një bazë të fortë për një integrim më të thellë ekonomik. Sinergia që rezultoi hap dyert për bashkëpunim të mëtejshëm ekonomik. Porti i Durrësit ka

shënuar një rritje të dukshme të trafikut nga tregtia e jashtme e Kosovës, duke u rritur 50 % më shumë se viti i kaluar. Ky fluks tregtar po përkthehet në të ardhura shtesë të konsiderueshme për Portin e Durrësit, duke e bërë atë dukshëm më konkurrues brenda rajonit. Ekonomia e Shqipërisë do të përfitojë

ndjeshëm nga ky zhvillim. Dogana e Kosovës sivjet ka arkëtuar 255 milionë euro nga procesi i zhdoganimit në Portin e Durrësit. E rëndësishme është se kjo është arritur pa asnjë implikim shtesë në kosto për fondet publike, falë efikasitetit të integritit. Duke u bazuar nga mësimet e vlefshme të nxjerra gjatë këtij

bashkëpunimi të suksesshëm, Dogana e Kosovës dhe e Shqipërisë po eksplorojnë në mënyrë aktive mundësitë për të shtrirë integritime të ngjashme në fusha të tjera me interes të përbashkët. Kjo qasje e të menduarit përpara premtion përfitime edhe më të mëdha ekonomike dhe logjistike në të ardhmen.

ASK-ja: Mbi 80 për qind e familjeve në Kosovë kanë përdorur drurin si lëndë djegëse

PRISHINË, 6 SHTATOR - Mbi 80 për qind e familjeve në Kosovë e kanë përdorur drurin si lëndë djegëse për ngrohje, kurse rreth 18 për qind e tyre kanë shpenzuar gaz, thuhet në raportin "Konsumi i Energjisë në Ekonomi Familjare, 2022", paraqitur nga Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK), duke shtuar se mesatarisht ngrohen rreth 52.67m2 për ekonomi familjare. "Sa i përket lëndëve djegëse, dru zjarri

ishte më i përdorur gjerësisht me një mesatare të përdorur në 82.33 për qind të ekonomive familjare. Po ashtu, vend të konsiderueshëm merr edhe GLN (gazi) me 17,8 për qind", thekson raporti. Sipas ASK-së, territori i Kosovës mbulohet 100 për qind me energji elektrike. "Territori i Kosovës mbulohet 100 për qind me energji elektrike, ndërsa për ngrohje përdoret dru zjarri në mesatare të 82.33 për qind të

ekonomive familjare", shton ASK-ja. Në fund të raportit thuhet se mbi 4 për qind e ngrohjes është siguruar nga sistemet qendrore. "Analizat e energjisë dhe lëndëve djegëse të konsumuara (sipas numrit të amvisërive) treguan se energjia elektrike është përdorur në 100 për qind të ekonomive familjare, 4.19 për qind nga ngrohja e blerë nga sistemet e ngrohjes qendrore", përfundon raporti.



Grupi 403 dhe të tetëdhjetat e rokut në Kosovë

Nga: **Blerim SHALA**

(publikuar për herë të parë në *Javoren Politike Shqiptare "Zëri"*, janar 2003)

Përshtypja e parë që krijohet kur dëgjon CD-në e grupit "403", të edituar pak ditë para se viti 2002 përfundoi, është që ne, brezi të cilit i takojnë edhe 403-shat, i kemi së paku 100 vjet jetë!

Kjo përshtypje nuk duket fare teprim kur dihet sa shumë vdekje kemi parë në jetën tonë.

Po flas për vdekjen e një sistemi (komunist), të një rendi ndërkombëtar (të Jaltës a "Luftës së Ftohtë"), të një shteti (RSFJ-së), të një okupimi (të Serbisë).

I ndjeri profesor [Fehmi] Agani, në ato çastet e fundit të Konferencës së Rambujesë, në episodin e marsit në Paris, kur përmendej treziku që Serbia – në momentet e nisjes së fushatës së Paktit NATO – të fillojë me vrasjen edhe të anëtarëve të delegacionit të Kosovës, me atë sensin e tij të njohur të humorit i cili nuk e braktiste edhe atëherë kur ishte më së vështirë, na pat thënë: Edhe nëse vdes, do të kam çfarë t'i tregojë Zotit. Të jesh dëshmitar i vdekjeve të tri Jugosllavisë, nuk është pak.

Midis marsit '81 dhe korrikut '90

Në të tetëdhjetat, kur në Kosovë u krijua një rok-skenë e qëndrueshme, ishte vështirë të paramendohet që për një duzinë vjetësh Evropa dhe bota do të ndryshojnë aq shumë.

Gjithçka rreth nesh dukej e amshueshme: Prej zyrtarisë politike dhe kulturore, një paperspektive individuale, një establishmenti politik që s'dinte të gjendej fare në ato rrethana, komunizmit si rend shoqëror që nuk do të ndryshojë dot, Jugosllavisë si shtetit i cili dukej kobi i shqiptarëve. Në atë ambient ngulfatës kishte fare pak oaza ajri ku mund të merrje frymë më lirë. Njëra prej tyre ishte roku. Ishte një lloj strehimoreje prej letre dhe ne e dinim mirë këtë. Më kujtohet që me një rast fqinji im serb kishte lëshuar me të madhe radion ku transmetohej njëri prej "Mitingjeve të vërtetës", të cilat njëmend ishin të tilla. Aty, ai askund më parë, tregohej fytyra e vërtetë e një regjimi dhe e një populli. Në atë pafuqinë time, i vura altoparlantët në dritare dhe lëshova The Sisters of Mercy.

Roku kosovar i të tetëdhjetave do të zhvillohet në mes dy gurëve kufitarë të cilët shënojnë, për Kosovën, dy çaste sipërore në historinë e re: 11 marsin e vitit 1981 dhe 5 korrikun e vitit 1990.



Në marsin e 81-shit, Republika e Kosovës rrokullisej si kërkesë rrugëve të Prishtinës dhe të Kosovës. Në korrikun e 90-tës, ajo kishte zënë vend në Kuvendin e Kosovës.

Rok-ngjarja e fundit në platonë e Pallatit të Rinisë (atëbotë Qendrës "Boro e Ramizi") u shënua më 5 korrik 1990. Nëse nuk harroj, ishte Migjeni (Kelmendi) me "Gjurmët".

Ajo natë Prishtinën e kishte zënë me Kuvendin e suspenduar nga Serbia, pa televizion, pa radio, me një ankth i cili ishte futur në secilin prej nesh. Teksa dëgjohej refreni "Më trego si të bëhem hero...", secili prej nesh përballej me dy konkludime: I pari ishte më i lehti, i bërjes-qejf-vetit që e tëra do të kalojë së shpejti, që bota tashmë do ta shohë sa janë të vrazhdë ata e sa jemi viktimat ne. I dyti ishte më i vështiri dhe më real: Nuk kemi ku të kthehemi prapa, kemi shpallur republikën, duhet ta jetësojmë me çdo kusht, pa marrë parasysh çmimin. Më 2 korrik të vitit 1999, dhjetamijëra shqiptarë për herë të parë shënuan të lirë, rrugëve të Prishtinës, Ditën e Republikës.

Sizifi dhe Stonesat

Roku në Kosovë, deri në këto ditë e reja të pasqershorit të vitit 1999, ka pasur fare pak gjasa të mbijetojë. Të thuash, gjithçka ishte kundër tij. Të gjithë ata që i druanin ndryshimeve, mendonin që me një këngë, me flokë të gjata, me farmerka dhe me zhurmë altoparlantësh mund të prishet një rend (shtetëror, shoqëror, kulturor etj.), të cilit qëmoti i kishte skaduar afati i përdorimit. Rok-artistët shiheshin para së gjithash si rebelues, narkomanë,

mbase edhe fundërrina. Ata, në anën tjetër, e dinin mirë që roku në Kosovë nuk mund të jetë biznes, që prej tij, këndeipari, nuk mund të jetohej (me fitime të majme) dhe as të vdiset (nga droga dhe fama). Të paracaktuar për dështim, ata, e dinin që këtu gurët më tepër kanë të bëjnë me Sizifin se sa me Stonesat. Megjithatë, atyre nuk ju durohej pa bërë pak zhurmë, sa për t'i thënë vetes dhe dëgjuesve që qetësia kosovare ishte një rend që po kalbej dita më ditës.

Rok-këngë dhe grupe ka pasur në Kosovë edhe para të tetëdhjetave. MAK-u i Haki Misinit madje fitonte shpërblime edhe në Akordet e Kosovës me folk-rokun, i cili i qepej trendit të hapur në ish-RSFJ-në nga Bijelo Dugme. Megjithatë, tek në të tetëdhjetat, nën ndikime të ndryshme të rokut (prej new wave-t deri te hard rock-u), këtu vendoset një rok-skenë me grupe të cilat do të qëndrojnë për vite, apo edhe për decaenie (si "Minatori" i Naser Gjinovcit dhe Mufail Limanit).

Natyrisht, këtu nuk kam pretendime të bëj farë rekapitulimi të rokut kosovar në vitet e tetëdhjetave, i cili pati si përfaqësues më të denjë "Minatorin", "Irirët", "Gjurmët", "403"-shin, "Seleksionin 039", "Lindjen" etj. Atëbotë, me fare pak albume dhe më shumë, me xhirime në RTP, këto grupe mundoheshin të dëshmojnë se në Kosovë mund të mbijetojë roku. Rok-autorët e atyre viteve, zatën, si të gjithë ne të tjerët, për shkak të censurës e kishin vështirë të artikulojnë sinqerisht ndjenjat e tyre për kohën dhe për njerëzit. Me një metaforë, me një varg të ndërlikuar, me një porosi të fshehur, të mbështjellë me një

mori vargësh të kota, ata përpiqeshin "të thonë diçka". Në fundvitet e tetëdhjetave, kur këtu u rrënuar një sistem i rremë dhe u imponua okupimi i vërtetë, në atë periudhën tranzitore në pranverën e vitit 1990, rok-autorët si edhe të gjithë ne të tjerët, nisën të flasin pa dorëza (dhe me grushta të ngritur në shenjë revolte), për të keqtë që na kishte futur në thellësitë e honit. Kishte flirt me muzikën popullore (te "Minatori", "Irirët", "Gurmët"), për të dëshmuar që roku dhe atdhetaria nuk janë në kundërshti, apo, për të depërtuar më lehtë në masë.

Pastaj, në vijim të 5 korrikut të përmendur, roku në masë të madhe ishte i marginalizuar, tek tuk me ndonjë grup dhe ndonjë këngë të mirë.

Pas luftës, në Kosovë kemi gjithçka dhe çdo gjë. Edhe në rok dhe pop.

Udhëtimi në të kaluarën

Grupi "403" na dhuroi këto ditë CD-në e tyre e cila meriton të cilësohet si njëri ndër dy-tre albumet më të mira të edituara pas vitit 1999. Ky album ka 15 këngë, gjë që është dukuri shumë e rrallë te ne, ku zakonisht, të ashtuquajturat albume kanë tetë këngë. Është e vërtetë që në mesin e këtyre 15 këngëve ka shumë prej atyre që "403"-shin e kanë bërë grup shumë të rëndësishëm të të tetëdhjetave. Por, me produksionin e ri të Hektorit (Gjurgjialit), ato përbëjnë një tërësi dhe dëgjuesi i ri krijon përshtypje që albumi, i tëri, është rezultat i tre-katër vjetëve të fundit.

Për ne që jemi mocanikë të Hektorit, Mentorit dhe të tjerëve të "403"-shit, ky album është një udhëtim në të kaluarën,

përkujtues i ngjarjeve të shumta të cilat lidhen me këtë apo atë këngë të "403"-shit. Nuk mund të kemi nostalgji për atë kohë, por gjithsesi po për njerëzit, për idetë, për përpjekjet që disi të lëvizin gjërat. Asokohe, "403"-shi dukej rok - grupi më me perspektivë kosovar i cili, për shkaqe të ndryshme, kurrë nuk arriti atje ku meritonte.

Thashë më parë se roku këtu nuk ofronte mundësi për ekzistencë. Rokerët kosovarë, dashur e pa dashur, u shpërndanë nëpër botë dhe nëpër profesione dhe fate të ndryshme.

Kështu, u desh të kalojnë vite të tëra që "403" të ribashkohen dhe të incizojnë këtë album.


Ne që duam të shohim albume të mirëfilltë te rok-grupet tona, mund t'i gjejmë të meta të ndryshme këtij albumi. Ka gabime në bukletin e albumit, në tekste dhe në lekturë. Dikujt mund t'i duket që Hektorit, në synimin e tij për një produksion të pasur të këngëve, di edhe ta teprojë, prandaj ato produksionet "e egra" të të tetëdhjetave (në disa këngë) na duken tutje më të bukura se këto të reja. Megjithatë, në tërësi, ky është një album i shkëlqyeshëm, me këngë të cilat janë të paharrueshme. Ndër këto të reja, posaçërisht spikaten "Engjujt nuk jetojnë në tokë" dhe "Qyteti im".

Hektorit me shokë, as sot, në rrethana shumë të mira, nuk mund të jetojnë nga roku.

Por, ky album tregon se roku ka jetuar këtu te ne qëmoti.

Ky album i "403"-shit, më parë albumi rekapitulues i "Gjurmëve" dhe "Minatori" me kontinuitetin e prodhimit të albumave, dëshmojnë se Kosova kishte roku të mirë në të tetëdhjetat. /Telegrafi/

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Envert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Shqipëria synon fitore ndaj Çekisë



EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Kombëtarja e Shqipërisë në futboll sonte (e enjte) e zhvillon njërin prej ndeshjeve më të rëndësishme në këtë vit, pasi mund të këtë ndikim për kualifikimin në Kampionatin Evropian "Euro 2024". Kundërshtarë të kuqezinjve është Kombëtarja e Çekisë dhe ndeshja zhvillohet në stadiumin "Fortuna Arena" nga ora 20:45. Trajneri i Shqipërisë, Sylvinho është shprehur se ndeshja ndaj çekëve është shumë e rëndësishme, por jo vendimtare për kualifikimin. "Jam i kënaqur për gjendjen e skuadrës. Motivimi është i lartë dhe duhet të them se është një ndeshje e vështirë, djemtë e dinë këtë dhe ata janë mësuar të luajnë në të tilla ndeshje. E qartë që kërkohet një përgjegjësi më e madhe këtë herë, duke parë ndeshjen që kemi përpara. Ne e ndjejmë përgjegjësinë që kemi, këto janë ndeshje për t'u shfrytëzuar në mënyrën më të mirë. Janë ndeshje të rëndësishme dhe të gjithë duan të luajnë. Jam shumë i lumtur për këtë", ka thënë Sylvinho. "Ne në këtë moment nuk jemi akoma në gjysmën e ndeshjes. Mungojnë akoma edhe 5 finale. Të enjten do të jemi në 50% të rrugës dhe do të kuptojmë sa janë shanset tona. Nesër është e rëndësishme paraqitja, të ecim përpara në rrugën tonë, të bëjmë një lojë të bukur dhe të marrim pikë sepse ndryshe nuk arrijmë dot

tek objektivi ynë. Llogaritë mund të bëhen vetëm në nëntor. Llogaritë nëse duhet të luanim për barazim ose fitore mund t'i shikojmë në nëntor, sot nuk bëhen llogari. Unë jam absolutisht i bindur se 23 lojtarët që kam në skuadër nesër do të zbresin në fushën e lojës për të fituar. Duam të bëjmë një ndeshje të mirë dhe të marrim pikë. Llogari nuk dua të bëj, ne jemi 100% të përqendruar te kjo ndeshje me Republikën Çeke. E thashë edhe më parë që kanë një trajner ekspert me lojtarë shumë të mirë, por edhe unë jam shumë i kënaqur me lojtarët që kam. Kemi lojtarë të fortë, jemi një skuadër e fortë dhe do të zbresim në fushën e lojës për të bërë mirë", ka deklaruar Sylvinho. Në konferencë për medie i pranishëm ishte edhe mbrojtësi Berat Gjimeshiti, i cili ka thënë se kuqezinjët do të hynë në fushë për të marrin maksimumin dhe më pas do të mendojnë për Poloninë. "Grupi sapo është formuar goxha dhe jemi një grup me më shumë eksperiencë, lojtarë të rinj që japin më shumë. Kemi besimin që është 100% te ne. Nëse nuk beson gabon që luan në këto ndeshje. Me Çekinë gjithmonë vendimtare janë tre pikët. Janë pesë ndeshje finale që do të japim maksimumin dhe më pas do të shohim ku do të renditemi", ka deklaruar Gjimeshiti. Në Grupin E, Shqipëria është e dyta me 6 pikë, kurse në anën tjetër Çekia është e para me një pikë më shumë se kuqezinjët.

SHKURT

Gjyqtarët e Kosovës ndajnë drejtësinë në ndeshjen San Marino - Norvegjia U21

UEFA vazhdon delegimin e gjyqtarëve të Kosovës në garat evropiane në nivel klubesh e në nivel të kombëtareve. Kësaj radhe një katërshe e gjyqtarëve të Kosovës është deleguar për ndeshjen kualifikuese të kombëtareve U21 për Euro 2025, ndërmjet San Marinos dhe Norvegjisë, e cila zhvillohet të enjten në orën 18:00. Gjyqtarë kryesor do të jetë Mervan Bejtullahu, me asistentë Edmond Zeqirin e Fatmir Sekiraqën, ndërsa gjyqtar i katërt do të jetë Vigan Ibërdemaj.

Tami për lojtarët shqiptarë: Kthimi në atdhe do të zgjojë emocione të veçanta

Kosova do të ndeshet me Zvicrën me datë 9 shtator në stadiumin "Fadil Vokrri" në kuadër të kualifikimeve për Kampionatin Evropian. Drejtori i Kombëtares së Zvicrës, Pierluigi Tami, ka thënë se për disa lojtarë kthimi në atdhe do të zgjojë emocione të veçanta. "Për disa lojtarë kthimi në atdheun e tyre mund të zgjojë emocione të veçanta", ka thënë Tami. Granit Khaka, Xherdan Shaqiri, Ardon Jashari dhe Uran Bislimi janë futbollistët me prejardhje shqiptare që do të jenë pjesë e Zvicrës në ndeshjen e së shtunës. Tri ditë më vonë Zvicra do të ndeshet në shtëpi me Andorrën, kurse Kosova udhëton për përballje me Rumaninë.

Sot hidhet shorti për Superligat e basketbollit

Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) ka njoftuar se sot (e enjte) do të hidhet shorti për Superligat e Kosovës në basketboll. "Në zyrat e FBK-së nga ora 11:00 do të bëhet hedhja e shortit për edicionin e ri të Prince Caffè Superligës, kurse nga ora 11:30 do të bëhet tërheqja e shortit për Superligën e Femrave", thuhet në njoftimin e FBK-së. Përfaqësuesit e klubeve janë të mirëseardhur për ta parë tërheqjen e shortit. Edicioni i ri në Prince Caffè Superligën e Kosovës në basketboll do të fillojë më 22 shtator, ndërsa xhironja e parë te femrat është më 6 tetor.

Berisha: Nuk ka ndjenjë më të mirë sesa ta përfaqësosh vendin tënd

Përfaqësuesja e Kosovës në futboll më 9 shtator përballet me Zvicrën dhe tri ditë më vonë do të luajë në udhëtim te Rumania. Bernard Berisha është rikthyer në ekipin përfaqësues pas një kohe të gjatë, teksa ka folur për dy sfidat e radhës. "Nuk ka ndjenjë më të mirë se me përfaqësu vendin tënd. Unë kam qenë gjithmonë i gatshëm dhe shpresoj të rikthehem te rezultatet pozitive", ka thënë Berisha. "Unë e kam cekur edhe më herët se kemi një grup shumë të mirë, gjitha kushtet i kemi të plotësuar dhe nuk na mbetet gjë tjetër vetëm të përqendrohemi në dy ndeshjet që kemi dhe të tregohemi ata që ishim më herët", ka deklaruar Berisha. "Duhet të përgatitemi maksimalisht për dy ndeshjet sepse janë shumë të vështira dhe duhet të tregojmë në fushë. Me besimin në Zot dhe me përkrahjen e tifozëve jam i bindur se do të kemi rezultate të mira", ka shtuar Berisha.

Beka për mediet zvicerane: Ndaj Zvicrës është ndeshja e jetës sime

Cyrih, 6 shtator - Mbrojtësi i Luzernit, Ismajl Beka, u ftua nga Kosova për herë të parë për ndeshjen ndaj Zvicrës dhe Rumanisë. Ndeshja me Zvicrën është speciale për Bekën, pasi ai luan në këtë shtet. "Të jesh në gjendje të luash për vendin tënd është një

ndjenjë e madhe dhe e papërshkrueshme", ka thënë Beka me krenari për "Blick". Ai foli edhe për ftesën e ardhur nga Kosova. "Së bashku me familjen time vendosa të luaj për Kosovën. Është loja e jetës sime. Në këto 90 minuta do të kem

emocione shumë të veçanta. Për këtë duel vjen e gjithë familja ime nga Zvicra dhe aty do të jenë edhe shumë të afërm të mi në Kosovë", ka shtuar Beka. Ndeshja në mes të Kosovës dhe Zvicrës zhvillohet të shtunën në "Fadil Vokrri".



Daku dhe Muja: Ndjenjë fenomenale, jemi shumë krenarë

TIRANË, 6 SHTATOR - Kombëtarja e Shqipërisë sonte në Pragë zhvillon ndeshjen ndaj Republikës së Çekisë. Një sfidë shumë e rëndësishme për kuqezinjët e trajnerit Sylvinho të cilët, ashtu si edhe tifozët, ëndërrojnë kualifikimin në Evropianin e vitit 2024. Kësaj

radhe në listën e teknikut Sylvinho janë edhe dy risi, "bomberi" i Antwerpit, Arbnor Muja dhe i Rubin Kazanit, Mirlind Daku, me këta dy të fundit që në një intervistë për FSHF-në kanë treguar emocionet e tyre të para si pjesë e "kuqezinjve". "Mirë,

shumë mirë. Kemi pasur pak probleme për 'dritën jeshile' për ta përfaqësuar kombëtaren, por shqyrr u krye dhe tepër mirë këto ditët e para", ka thënë Daku për përvojën e re me "kuqezinjët". "Mirë edhe për mua. Një ndjenjë fenomenale të jesh në

kombëtare me djemtë, të takohesh me ta si dhe ta njohësh stafin. Gjithçka shumë mirë. Kur mora ftesën, për herë të parë fola me familjen. Krenari e madhe si për të ashtu edhe për mua. Nëna ka qenë



më e lumtura kur e mori vesh", ka deklaruar Muja.

FBK-ja licencon tri klube, njëmbëdhjetë të tjera me kusht

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Federata e Basketbollit e Kosovës ka licencuar tri klube, kurse njëmbëdhjetë të tjera janë licencuar me kusht. Bordi i FBK-së, pas shqyrtimit të aplikacioneve të klubeve nga komisioni për licencim, ka marrë vendim për licencimin e klubeve të Prince Caffè Superligës dhe Superligës së Femrave. Klubet e licencuara plotësisht janë:

KB Istogu, KBF Bashkimi dhe KBF Trepça. Ndërsa klubet e licencuara me kusht janë KB Vëllaznimi, KB Golden Eagle Ylli, KB Trepça, KB Sigal Prishtina, KB Proton Cable Prizreni, KB Bashkimi, KB Peja, KBF Peja 03, KBF Prishtina, KBF Penza dhe KBF United Basketball. "Klubet e licencuara me kusht kanë afat deri më 12 shtator 2023 të plotësojnë dokumentacionin e

nevojshëm, me ç'rast fitojnë statusin e klubit të licencuar plotësisht. Në të kundërtën, konform nenit 4, alineja 3 e rregullores për licencim dhe garim, 'pa posedim të licencës, asnjë subjekt nuk mund ta ushtrojë të drejtën e pjesëmarrjes në ndonjë garë ose organizimit të ndonjë gare të basketbollit", thuhet në njoftimin e FBK-së.



Perezi: Mund të largohem nga Red Bulli

MILTON KEYNES, 6 SHTATOR - Piloti mexikan i Red Bullit, Sergio Perez, për herë të parë në një intervistë për DAZN ka konfirmuar se mund të largohet nga kjo makinë kur të përfundojë kontrata. Ai e nisi mjaft mirë sezonin, me dy fitore, dy vende të dyta dhe dy podiume, por shpejt ai humbi ritmin e shokut të skuadrës Max Verstappen. Ai ka siguruar sërish dy vende të dyta në dy garat e fundit, por nuk arrin dot ta fitojë betejën me holandezin, shokun e tij të skuadrës. "Çdo vit mësoj gjëra të reja dhe për këtë arsye e dua këtë sport. Nga ky sezon është e rëndësishme që të zhvilloj garat e ardhshme në një ambient ku ndjej se mund të jap kontributin tim. Nëse nuk do të ketë vend për mua në vitin 2024, do të kërkoj për alternativa të tjera. Objektivi im kryesor është



të qëndroj këtu, të fitoj këtu, të fitojmë bashkë me Red Bullin titujt kampionë. Kam një kontratë deri në fund të vitit 2024 dhe besoj se gjatë vitit tjetër do të diskutojmë për të ardhmen time", ka thënë Perez. "Mendoj se momentet e vështira janë lënë pas dhe ndihem më komod

me makinën. Max është në një nivel më të lartë se unë. Nuk është e lehtë të jesh në një mjedis të tillë, me kaq shumë presion. Nuk është e lehtë të jesh shoku i skuadrës së Verstappenit, pasi u përshat më mirë me ndryshimet, ndërsa unë jo", ka deklaruar Perez.

Carvajal: Të gjithë po prisim ardhjen e Mbappes

Kylian Mbappe nuk arriti ta kompletonte transferimin te Real Madridi teksa vendosi në minutën e fundit të qëndronte te kampioni i Ligës 1, PSG-ja.

Lidhur më këtë temë ka folur edhe mbrojtësi Dani Carvajal, i cili për mediet u shpreh se të gjithë ishin në pritje të mbërritjes së francezitet. "Nuk

do t'ju them se nuk ka pasur diskutime, por në disa biseda para-sezonale pas darkës u dëgjuan lloj-lloj opinionesh. Unë me të vërtetë mendova se

ai do të vinte dhe unë me të vërtetë mendoj se Real Madridi do të ishte opsioni i tij i pëlqyer. Menduam se do të na bashkohej, por më pas

diçka shkoi keq dhe Mbappe nuk erdhi. Ai është një nga më të mirët dhe më të mirët luajnë për Madridin", ka thënë Carvajal.

SHKURT

Pesë sportistë përkrahen për 'MilanoCortina2026'

Komiteti Olimpik i Kosovës ka zbuluar listën e bursistëve që do të përkrahen për Lojërat Olimpikë "MilanoCortina2026". Pesë sportistët e skijimit alpin do të përkrahen nga 600 dollarë në muaj falë mbështetjes së marrë nga Solidariteti Olimpik i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar. Arbi Popovci, Drin Kokaj, Klos Vokshi, Kiana Kryeziu dhe Lirika Deva janë përfituesit. "U urojmë fat dhe suksese skitarëve tanë në rrugën drejt normës olimpikë", shkruhet në njoftimin e Komitetit Olimpik të Kosovës. Këto lojëra do të zhvillohen gjatë këtij dimri.

Gjermania kualifikohet në gjysmëfinale

Gjermania ka arritur të kualifikohet në gjysmëfinale të Kampionatit Botëror të Basketbollit. Gjermanët triumfuan ngushtë 81:79 ndaj Letonisë në çerekfinale. E gjithë ndeshja ishte pothuajse tërësisht e barabartë, por dallimi u bë në çerekun e dytë, kur Gjermania triumfoi 23:18. Në gjysmëfinale Gjermania do të ketë mision tejet të vështirë, pasi do të përballet me favoriten kryesore, Amerikën.

Martinezi në historinë e Interit, mes 10 golashënuesve më të mirë

Me dy golat e shënuara kundër Fiorentinës, Lautaro Martinez bëhet pjesë e historisë së Interit. Ai është i 10-ti në listën e golashënuesve të të gjitha kohëve te zikaltrit. Sulmuesi argjentinas deri më tani ka shënuar 107 gola me fanellën e Interit. Synimi i radhës është të kalojë dy emra të njohur, Bobo Vieri dhe Mauro Icardi, respektivisht me 123 dhe 124 gola. Kujtojmë që në vendin e parë për gola të shënuar qëndron Meazza me 284 gola.

Joao Felix refuzoi katër klube angleze për Barcelonën

Portugezi Joao Felix plotësoi ëndrrën e tij të fëmijërisë, duke kaluar te katalanasit e Barcelonës. Prestigjiozja spanjolle "Mundo Deportivo" ka publikuar disa prapaskena tepër interesante të kësaj merkatoje vere, të lidhura pikërisht me ish-fantazistin e Benficës, Chelseat dhe Atletico Madrid. Sipas raportimeve të spanjollëve, "të kuqtë" e Liverpoolit u kishin propozuar "bardhekuqve" të Atletico Madridit një shkëmbim mes Darwin Nunez dhe Joao Felix, mirëpo ky i fundit nuk kishte pranuar. Përveç Liverpoolit, Felix refuzoi ofertën edhe nga Manchester Unitedi, Aston Villa dhe Tottenham Hotspuri.



QENDRA E KOMPETENCËS
"SHTJEFËN GJEÇOVI"
Prishtinë



Prishtinë 10000 Kosovë. Rruza "TIRANA" nr. 125 Tel. +383 (0) 38 613 026

Nr.832/1
Datë: 06.09.2023

Bazuar në nenin 28, paragrafi 2 të Ligjit nr. 04/1 – 138, i datës 28.02.2013 për arsimin dhe aftësimin profesional dhe në bazë të nenit 12, paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/L – 143, i datës 13.12.2012, për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës dhe në bazë të rregullores (MASHT) nr. 01/2017, të datës 02.02.2017, për planifikimin dhe shpenzimin dhe aftësimin profesional dhe arsimin për të rritur, Drejtorja e Arsimit, shpall :

KONKURS

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) për vijimin e mësimin për të rritur në Qendrën e Kompetencës "SHTJEFËN GJEÇOVI" në Prishtinë, për vitin shkollor 2023/2024, afati i Janarit.

Për këto profile :

- Dirigjimi kompjuterik i makinave
- Metalpunues
- Automekanik
- Makaronikë
- Instaluesi i ujësjellësit dhe kanalizimit dhe ngrohjes dhe klimatizimit
- Konfeksioner
- Rrobaqepës
- Transport rrugor
- Trafik rrugor
- Transpor hekurudhor (Drejtues i trenave, Lëvizje e trenave, Tërheqje e trenave).

KUSHTET :

Regjistrimi i vijuesve në programin arsimit për të rritur bëhet sipas procedurave të njëjta të regjistrimit për nxënës të rregullt siç është paraparë në Ligjin nr.04/L – 143 për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimeve të MASHT-it, UA 11/2011, UA 16/2011 i datës 30.12.2011 ; UA 12/2014, i datës 05.05.2014, dhe UA 13/2014, i datës 05.05.2014.

Të drejtë regjistrimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët kanë moshën për të qenë nxënës të rregullt.

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

- Dëftesa e klasëve të kryera paraprake
- Certifikata e lindjes
- Pagesa

Shkollimi në nivelin e arsimit të mesëm të lartë është me pagesë. Partecipimi bëhet në bazë të UA 11/2011, i datës 30.12.2011.

Pagesa e regjistrimit për vijuesit e arsimit për të rritur:

- | | |
|--|----------|
| a) Për regjistrim të vitit për një klasë | 100,00 € |
| b) Për praktikë profesionale | 50,00 € |
| c) Për provim diferencial | 10,00 € |
| d) Provimi përfundimtar /certifikata – diploma | 50,00 € |

Pagesat bëhen në institucionet financiare sipas kodit të shkollës.

Dëftesat dhe diplomat që merren në programin "Arsimi dhe aftësimi për të rritur" janë të barasvlershme me diplomat e arsimit formal.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.

Drejtori: Blerim Gërvalla



FEDERATA E SINDIKATAVE TË SHËNETËSISË SË KOSOVËS

Shpallë konkurs:
Pozita 1: Zyrtar/e Ligjor,
Vendi: Zyra Regjional në Gjilan

Detyra dhe përgjegjësitë:

- Jep këshilla juridike nga legjislati i punës,
- Ofron ndihmë në përpilimin e mjeteve juridike për mbrojtjen e të drejtave (ankesa, kërkesa, parashtrës, njoftime, padi, etj)
- Sipas kërkesës dhe udhëzimeve të nivelit të lartë jep opinione ligjore të akteve normative si dhe akteve tjera juridike të cilat dalin nga fushë veprimtarie e institucionit,
- Bënë përfaqësim në procedurat disiplinore, gjyqësore, administrative dhe të tjera sipas nevojës,
- Asiston në takime me punëdhënësin,
- Kryen shërbime të tjera profesionale nga lëmia e marrëdhënies së punës,
- Bashkërendon dhe koordinon punët me zyrtarët tjerë ligjor për çështjet e institucionit.

Kualifikimet e nevojshme për pozitën:

- Kandidati duhet të ketë kryer Fakultetin Juridik,
- Është e preferuar të ketë përvojë profesionale së paku një vite,
- Shkathtësi të mirë të menaxhimit të kohës, detyra dhe shkathtësi komunikative.
- Ai/Ajo duhet të jetë në gjendje që të punojë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe të ketë shkallë të lartë të integritetit. Afinitet për punë në administratë është i dëshirueshëm.
- Shkathtësitë e punës me kompjuter duke përfshirë programet përpunuese Word, Excel, Internet Explorer etj.
- Të ketë njohuri në kontabilitet dhe financa,
- Përparsi njohje e rrjedhshme të gjuhëve: shqipe, anglisht ose serb-kroate.

Të gjithë të interesuarit duhet të dërgojnë CV-it me fotografi dhe me dokumentacionin përcjellës deri me datë 14.09.2023 ora 15:00, në zyrën Qendrore të FSSHK-së me adresë: Rr.Mustaf Kruja Z4-S3, Kati-5 Nr.17 ose në e-mail: info@fsshk.eu. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen për intervistë.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Blerta Bala nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës së: 10,11,12,13 të shkollës "Hajdar Dushi".

- Nertila Tafarshiku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi".

- Muhamet Kadrija nga Gjakova shpall të pavlefshme Licencën e Punës me numër: KO-0714-06-20 të lëshuar nga Oda e Infermierëve të Kosovës (OIK).

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

